




Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosova



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK  
Nr. i faq 02  
Nr. pages 02

01-1731/2012  
Dat 14-05-2012

<b>DATË/A:</b>	14.05.2012
<b>REFERENC-Ë:</b>	AKK-DPK
<b>PËR/ZA/TO:</b>	z. Jehona Krasniqi Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm.
<b>CC:</b>	z. Fatmir Uka Drejtor i Administratës në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm
<b>NGA/OD/FROM:</b>	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Opinion lidhur me tenderin “Servisimi dhe Mirëmbajtja e Veturave të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm”



Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin “Servisimi dhe Mirëmbajtja e Veturave të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm” me numër prokurimit 302-012-006-121 ofron këtë:

**OPINION**

Ju si autoritet kontraktues Zyra e Prokurimit t’i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të cekura në arsyetim, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 04-L/042.

**A r s y e t i m**

Zyra e prokurimit në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit “Shërbime” të procedurës së hapur kontrata publike kornizë me nr. prokurimi 302-012-006-121 dhe titull tenderi “Servisimi dhe Mirëmbajtja e Veturave të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm” në Pjesën, Seksioni II, Fleta e të dhënave të tenderit te neni 9.1 i Dosjes së tenderit te Kërkesat mundësit teknike dhe /ose profesionale pika 8 Dokumentet e Kërkuara – ka kërkuar që Operatori Ekonomik ta ketë një pikë të servisimit të automjeteve jo më larg se 20 km largësi nga qendra e ndërtesës ZAP (Dëshmi me shkrimë) nga kjo rrjedh se departamenti i prokurimit ka bërë diskriminim territorial gjë që paraqet shkelje të nenit 7 pika 4 LPP-së 04/L-042.

Zyra e prokurimit në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit, të PJESA C, Formulari i dorëzimit tenderit të pika 4 ka plotësuar validitetin e ofertës për një periudhë prej 90 ditë nga data finale për dorëzimin e tenderit gjë që nuk është në përputhje me **nenin 20** Rregullores për Prokurim Publik ngase këtë pikë duhet plotësuar Operatoret Ekonomik.

Me respekt!

